



Ndal Punës së Fëmijëve

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve
nëpërmjet edukimit,
artit dhe medias

Mjetet e komunikimit, shtypi

Organizata Ndërkombëtare e Punës

Objektivi: Sigurimi i komunikimit me mjetet e komunikimit për të tërhequr vëmendjen e publikut ndaj punës së fëmijëve. Të kuptosh si punon media. Të mësosh të shkruash një njoftim për shtyp dhe të përpiqesh që ta botosh atë.



Përfundimi: Rrit fuqimisht ndërgjegjësimin dhe integrimin e komunitetit, duke shtuar efektin shumëfishues.



Koha

2 orë mësim, veç e veç ose të dyja së bashku.

Motivimi

Një ndër komunitetet kryesore që duhet të përfshihet në luftën kundër punës së fëmijëve, është komuniteti i mjeteve të komunikimit. Në kohën tonë të komunikimit të njëkohshëm global, është shumë e rëndësishme të shfytëzohet media si një forcë lëvizëse shumë e madhe në përhapjen e ndërgjegjësimit shoqëror për punën e fëmijëve.

Për këtë arsye, kësaj teme i kemi kushtuar dy module: i pari merret me shtypin (gazetat dhe revistat), ndërsa i dyti me radion dhe televizionin. Që të dyja modulet përpiqen të sigurojnë informacionin e duhur për të rinjtë, që të arrijnë të përfshijnë median në projektin e tyre, duke informuar më shumë persona të komunitetit në lidhje me atë që bëjnë, dhe për të gjetur mënyrat që vetë komuniteti të jetë më bashkëpunues.





Shënim për përdoruesin

Para se të filloni të zhvilloni këtë modul, duhet të keni përfunduar modulën “Kërkimi dhe informacioni”.

Në ushtrimin që merret me përzgjedhjen dhe prerjen e artikujve nga gazetatat, të rinjtë analizojnë përmbajtjen e shkrimeve që trajtojnë kryesisht punën e fëmijëve dhe shkeljen e të drejtave të njeriut. Pikërisht, kjo analizë i ndihmon ata të veçojnë titujt që tërheqin vëmendje, faktet kryesore, mënyrën e trajtimit, hyrjet e mira etj. Kjo gjë do t'i ndihmojë pjesëmarrësit të realizojnë me sukses veprimtaritë e këtij moduli.

Përparësia e moduleve për mjetet e komunikimit është se të rinjtë vënë në jetë të gjitha njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë realizimit të moduleve të tjera. Në këtë mënyrë, ata vlerësojnë në praktikë vlerën që kanë të gjitha njohuritë e fituara. Ata mund të shprehin dhe të tregojnë për punën e fëmijëve, për fatkeqësitë që i shoqërojnë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme bashkëmoshatarët e tyre në të gjithë botën. Duke shfrytëzuar fuqinë e medias, mund të krijojnë histori dhe t'u kërkojnë ndihmë të gjithëve që të veprojnë. Ky modul bashkërendohet shumë mirë me modulet e tjera, si, p.sh., me shkrimin krijues. Aftësia për të shkruar do t'i ndihmojë të rinjtë të përpilojnë njoftimet për shtyp dhe letrat për gazetarët.

Në përgjithësi, është e rrallë që të rinjtë t'u jepet mundësia të trajtojnë çështje të rëndësishme. Ky modul ua jep këtë mundësi që të afirmohen në komunitetin e tyre. Në shoqërinë e sotme, puna me mjetet e komunikimit merr një rëndësi të dorës së parë, pasi lajmi dhe informimi mbizotërojnë gjithë jetën ekonomike, politike, shoqërore të të gjitha vendeve. Ky modul mund të jetë shumë i rëndësishëm për karrierën dhe profesionin e ardhshëm të të rinjtë. Nëpërmjet veprimtarive të modulit, mund të vlerësoni mundësitë dhe karakterin e të rinjtë me të cilët punoni. Disa nga cilësitë që mund të veçohen nëpërmjet këtij moduli, janë: autoriteti, komunikimi dhe ndjeshmëria.

Përgatitja

Për zhvillimin e këtij moduli, duhet të zgjidhni kohën më të përshtatshme dhe programojeni me kujdes.


Së bashku me të rinjtë duhet të takoheni me gazetarë dhe kryeredaktorë të gazetave, para se të përgatisni dhe t'u paraqisni një njoftim për shtyp. Duhet t'i njoftoni paraprakisht për qëllimin tuaj që t'u jepni një njoftim, si dhe t'i njoftoni për problemin që do të trajtoni në të, pasi në të gjitha organet e shtypit puna programohet.

Vetëm në këtë mënyrë do të jeni në gjendje të dini paraprakisht kohën kur do të botohet njoftimi. Nëse nuk e bëni këtë, rrezikoni që njoftimi të mos botohet ndonjëherë dhe në këtë mënyrë zhgënjeni thellë të rinjtë. Prandaj zgjedhja e kohës kur do të zhvillohet moduli, është e rëndësishme.

Artikujt e gazetave janë shumë më tërheqës, nëse janë të ilustruar me foto, prandaj një ndër kërkesat tuaja ndaj botuesit duhet të jetë sigurimi i ilustrimit. Për këtë ju vetë duhet të interesoheni për të gjetur fotot e duhura që do të mbështesin përmbajtjen e njoftimit që do të paraqitni.

Nëse keni miq apo kolegë që janë të gatshëm për t'ju ndihmuar, pranojeni ndihmën e tyre, pasi është me vlerë. Ndoshta ndonjë prej prindërve të të rinjve të grupit punon me media, në këtë rast ftojeni t'ju ndihmojë.

Mund të ndodhë që redaksia e gazetës apo e revistës të caktojë një gazetar t'ju ndihmojë për realizimin e modulit. Ky person mund t'u flasë të rinjve rreth punës së gazetarit dhe si mund të botohet një artikull. Të rinjtë që ndjekin veçanërisht televizionin apo dhe radion, janë të interesuar të dinë si funksionojnë mjetet e komunikimit. Duke patur edhe mbështetjen e medias lokale apo dhe kombëtare, do të arrini të tërhiqni vëmendjen për punën që bëni me të rinjtë, duke përgatitur kështu terrenin për publikimin e njoftimit për shtyp apo dhe realizimin e ndonjë interviste. Në të kundërt, mund të kërkonti ndihmën e ndonjë specialisti të komunikimit.



Ndihma e jashtme

Çfarë duhet



- ✓ Letër, laps dhe penë,
- ✓ Dërrasë e zezë, dërrasë e bardhë ose me fletë lëvizëse,
- ✓ Telefon nëse është e mundshme.



Zhvillimi i modulit

Mënyra si zhvillohet moduli, kushtëzohet nga disa faktorë:



- nëse keni arritur të siguron ndihmën e ndonjë relatori të medias;
- nëse keni një koleg, një mësues a ndihmës të jashtëm për të zhvilluar modulin;
- nëse sesionet do të zhvillohen nga vetë ju apo nga të jashtëm.

Pavarësisht nga faktorët e mësipërm, forma që po ju ofrohet më poshtë, është e mjaftueshme që ju vetë të siguron zhvillimin normal të modulit edhe nëse nuk keni patur një përvojë të mëparshme.

Organizmi i grupit

Realizimi i modulit varet në një masë të ndjeshme nga përbërja e grupit dhe interesit që ka secili anëtar i tij për të. Për të përpiluar një njoftim për shtyp, duhet që ai të shkruhet. Për këtë, mënyra më e mirë për ta bërë, është të krijoni nëngrupe të vogla me dy ose tre veta. Ushtrimet do t'i ndihmojnë të rinjtë të krijojnë besim në vetvete që është i domosdoshëm para se të ballafaqohen me të vërtetë me mjetet e komunikimit.

Është mirë që ky modul të zhvillohet pas modulit “Shkrimi krijues”, gjatë të cilit ju mund të keni piketuar disa nga të rinjtë që kanë një farë talenti në të shkruar. Këta të rinj nuk duhet të bien në të njëjtin nëngrup pune, por të shpërndahen në mënyrë që të ndihmojnë edhe të tjerët. Fare mirë ata mund të luajnë rolin e kryetarit të nëngrupit, që do të jetë një ndihmë për ju.



Përgatitja e mjedisit të punës

1 orë mësimi

Edhe në ditët e sotme kur teknologjia e informacionit është shumë e zhvilluar, nuk mund të nënvleftësohet fjala e shkruar. Një njoftim për shtyp, i shkruar mirë dhe që tregon një histori interesante, është shumë efektiv në publikimin e projektit tuaj dhe në fushatën kundër punës së fëmijëve.

Nëse tashmë keni vendosur lidhje me një përfaqësues të shtypit, do ta keni më të lehtë si fillim të procesit didaktik. Para se të filloni veprimtarinë, jepini këtij personi mundësinë që t’i flasë grupit. Në mbarim të fjalës së tij, jepini kohë grupit të bëjë pyetje. Mund të ndodhë që të rinjtë të jenë të ndrojtur dhe të mos bëjnë pyetje, edhe pse kanë shumë për të bërë. Mbaheni të gjallë bisedën, duke bërë ju vetë pyetje. Kjo do të thyejë akullin dhe të rinjtë do të ndiehen më të lirshëm për të bërë pyetje.

Mos harroni që disa ditë pas bisedës t’i dërgoni një letër falenderimi përfaqësuesit të shtypit. Këto sjellje edhe pse nuk ju kushtojnë, kanë vlerë shumë të madhe, pasi në të ardhmen këta njerëz tregohen më të gatshëm t’ju ndihmojnë.

Nëse nuk keni siguruar pjesëmarrjen e një të ftuari të botës së shtypit, ju vetë duhet të përgatiteni për t’u shpjeguar të rinjve si funksionon ajo. Ritmi i punës në gazetatat kombëtare, madje edhe në lokalet, është shumë i lartë. Ndodh që pjesën më të madhe të ditës, gazetarët janë jashtë zyrës për të gjurmuar lajmet, për të siguruar intervistat, për të bashkërenduar veprimtari të ndryshme, për të siguruar fotot etj. Më pas, kur kthehen në redaksi,

kanë përsëri punë, pasi shkrimi i artikullit kërkon kohë. Çdo ditë të javës duhet të mbushin faqet e gazetës, prandaj për ta koha është e çmueshme. Në këto kushte, mënyra më e mirë për t'u tërhequr vëmendjen, është të bëni një pjesë të punës së tyre. Pra, me fjalë të tjera, përgatitni një njoftim për shtyp, pothuajse të gatshëm për t'u botuar në rastet kur redaksia ka nevojë për këtë tematikë.


Veprimtaria 1

Hartimi i një njoftimi për shtyp (provë)

2 orë mësimi

Filloni veprimtarinë me të gjithë grupin. Shkruani në dërrasë të zeze fjalët e mëposhtëm që janë thelbësore për shkrimin e një njoftimi për shtyp. Shkruani vetëm fjalët që jepen të theksuara me të zeze, pasi fjalët e tjera do të plotësohen së bashku me të rinjtë.

- **Përcaktoni për çfarë flet ngjarja.** Që kjo ngjarje të botohet, duhet që përmbajtja e saj të tërheqë interesin e publikut. Ndoshta duhet trajtuar në mënyrë krijuese. Përqendrohuni në ato aspekte që janë të rëndësishme dhe të veçanta për projektin.
- **Shkruani me fjalë të shkurtra dhe të kuptueshme.** Aftësia e lexuesve për t'u përqendruar në frazat e gjata të artikujve, është e kufizuar.



Përmbliidhni shkurtimisht thelbin e ngjarjes në fjalitë hyrëse të artikullit. Të tregohet thelbi i ngjarjes në 4-5 rreshtat e parë, duke iu përgjigjur 5 pyetjeve:

kush?,
 çfarë?,
 kur?,
 ku?
 pse?

- **Përdorni citimet.** Përdorimi i citimeve apo thënieve të njerëzve të njohur të komunitetit për punën e fëmijëve, ka një vlerë shumë të madhe për projektin. Nëse nuk keni thënie të tilla, paraqisni fakte dhe drejtohuni dikujt të shprehet nëse pranon të citohet në vlerësimin e këtij fakti. Në këtë rast bëni kujdes. Para se të përdorni emrin e dikujt, duhet medoemos të merrni pëlqimin e tij.
- **Gjeni një titull interesant.** Titulli duhet të tërheqë vëmendjen e lexuesit. Gjetja e tij përbën një ndër momentet më kryesore të çdo shkrimi në gazetë. Përdorimi i nëntitujve lehtëson paraqitjen e shkrimit për lexuesin.
- **Mënjaroni përdorimin e zhargonit.** Artikulli i gazetës të ketë një gjuhë të pastër dhe të rrjedhshme. Përdorimi i zhargonit mund të ulë interesin e lexuesit.
- **Sigurohuni që njoftimi për shtyp të jetë sa më i shkurtër dhe i qartë.** Mënjaroni ujërat dhe theksoni pikat me të rëndësishëm që doni të komunikoni. Disa redaktorë, nëse ju paraqitet një njoftim për shtyp më i gjatë se një faqe, as marrin mundimin ta shikojnë e jo më ta botojnë. Nëse, nga njëra anë, është e vështirë të shprehesh diçka në një faqe, nga ana tjetër, kjo formë do t'ju ndihmojë të siguroni një stil efektiv në paraqitjen e çështjeve thelbësore të njoftimit.
- **Thoni kush jeni.** Në njoftim, në vendin që ju e gjykoni më të përshtatshëm, duhet të shpjegoni kush jeni dhe çfarë përfaqëson grupi juaj.
- **Siguroni një mënyrë të thjeshtë të komunikimit me median.** Është shumë e rëndësishme që gazetari të takojë menjëherë personin e duhur në rast se i duhet të sqarohet për njoftimin. Jepini të dhëna të sakta për t'u lidhur vetëm me një person, në mënyrë që të mos i duhet të shpërndahet në persona të ndryshëm për t'ju gjetur. Në rast të kundërt, nëse do t'i duhej të gjurmonte persona të ndryshëm, ndoshta humbet durimin.

Lëreni grupin të bëj pyetje dora-dorës që shkruhen këto çështje në dërrasën e zezë. Sigurohuni që i kanë kuptuar të gjitha çështjet dhe konceptet e tyre kryesore. Ju duhet të bëni pyetje që të nxirrni nëse të rinjtë i kanë kuptuar. Mbajeni gjallë interesin duke shpjeguar dhe duke e shoqëruar shpjegimin me shembuj.



Përcaktimi i detyrave

Ushtrimi shërben që të rinjtë të ndahen në nëngrupe të vogla, në mënyrë që secili prej tyre të hartojë një njoftim për shtyp. Objektivi në këtë fazë nuk është që detyrimisht të shkruhet një tekst. Në këtë moment do të ishte e vështirë që të rinjtë të përgatisnin tekstin, ndonëse nuk përjashtohet që disa nëngrupe t'ju befasojnë. Qëllimi është që të rinjtë të fillojnë të shkruajnë pa vështirësi dhe më pas të kenë mundësi të vazhdoni me shkrimin e një njoftimi për shtyp nga të gjithë së bashku (veprimtaria 2).



Para se t'i ndani të rinjtë në nëngrupe, është mirë që të krijoni një atmosferë të përshtatshme me brainstorming, ku rrihen mendime rreth titullit të njoftimit për shtyp. Redaksitë apo gazetarët (së fundi, edhe lexuesit), duke parë titullin, mund të interesohen për të lexuar artikullin. Nëse është organizuar ndonjë veprimtari, mund të përdoret në titull. Titulli mund të synojë të paraqesë projektin në tërësi. Mundohuni që të gjithë pjestarët e grupit lirshëm të shprehin mendimin e tyre për titullin. Shkruani në dërrasën e zezë propozimet e bëra, edhe tituj që janë argëtues, të papranueshëm, madje edhe të gabuar. Nxiteni grupin të shprehë mendime ekstravagante, të guximshme, duke krijuar kështu mundësi të gjeni një titull me të vërtetë domethënës.

Pas 5-10 minutave ndërpriteni veprimtarinë. Në vazhdim grupi voton për titullin më të mirë. Për ta bërë më të këndshme përzgjedhjen, mund të përdorni edhe elemente të garës, siç është caktimi i një ose dy çmimeve.

Pasi keni vendosur për titullin, shkruajeni në dërrasën e zezë dhe ftojini të gjitha nëngrupet të shkruajnë njoftimin për shtyp, duke u nisur nga treguesit e mëposhtëm:

- njoftimi për shtyp nuk duhet të përmbajë më shumë se 250 fjalë, që korrespondojnë me rreth një fletë të formatit A4;
- është e domosdoshme një paragraf hyrës me jo më shumë se 5 rreshta, ku të jepen përmbledhtasi çështjet kryesore të njoftimit, duke u bazuar në 5 pyetjet (kush?, çfarë?, kur?, ku? dhe pse?);
- njoftimi për shtyp të ketë të paktën një nëntitull; teksti të përmbajë të paktën një citim të thënë nga

edukatori apo dhe nga vetë të rinjtë e grupit.

- teksti të përmbajë një ngjarje, jo të rendisë thjesht fakte të mbledhura së bashku.

Jepini grupit 30-40 minuta kohë për të shkruar me qetësi njoftimin. Ndërkohë, sigurohuni që gjithçka po ecën mirë duke kaluar nga një nëngrup tek tjetri. Nëse e shikoni që një nëngrup ka vështirësi, uluni pranë tij dhe ndihmoni në shkrimin duke shfaqur mendimet e duhura në lidhje me atë që duhet të futet në njoftim. Nxitini të rinjtë të përdorin teknikën e 5 pyetjeve, që është gjithmonë e efektshme për shkrimin e një ngjarjeje, pasi i detyron t'u përgjigjen pyetjeve.

Nëse nëpër nëngrupe keni caktuar të rinjtë me prirje, të cilët i keni identifikuar paraprakisht, nuk do të ketë vështirësi në realizimin e këtij ushtrimi. Nuk janë shumë 250 fjalë, prandaj të gjithë të rinjtë duhet të jenë në gjendje të shkruajnë 1 faqe. Secili nëngrup duhet të caktojë një përfaqësues për të lexuar shkrimi e përgatitur.

Nëse mendoni se një element gare mund ta mbajë gjallë interesin e të rinjve, mund të vlerësoni me çmimin e punimit më të mirë njërin prej shkrimeve.

Shtesa1 paraqet një shkrim të shkruar nga dy të rinj, kur projekti pilotohej në Republikën e Irlandës më 2001. Teksti është botuar në një gazetë lokale dhe juve mund t'ju ndihmojë për realizimin e ushtrimit. Bëhet fjalë për një artikull përshkrues më shumë se një njoftim për shtyp, por është punë origjinale e dy të rinjve dhe, si e tillë, ka një vlerë më të madhe.



Veprimtaria 2

Shkrimi i një njoftim të vërtetë për shtyp

2 orë mësimi

Pjesa e dytë e këtij ushtrimi ka si qëllim që nga i gjithë grupi të shkruhet një njoftim për shtyp, i cili do të botohet në një gazetë apo revistë.

Përgatitja

Para se të filloni punën për realizimin e njoftimit përfundimtar që do të botohet, duhet të merrni takim me median që do ta botojë. Mund të përzgjidhni më shumë se një gazetë, mund të mendoni ta botoni në një gazetë kombëtare. Gjithësesi, për të mirën e të rinjve dhe për t'u dhënë atyre besim në vetvete, mundohuni ta botoni fillimisht në një organ lokal, ku është më e thjeshtë mundësia e botimit.

Ky është momenti i duhur për të shfrytëzuar ndihmën e jashtme. Gjithësesi përdorni të gjitha njohjet që keni për këtë.

Përfshini për këtë punë edhe grupin në vendosjen e lidhjeve me gazetarët. Përcaktoni momentin e duhur për të marrë takim me redaksinë. Shumë gazeta dalin një apo dy herë në javë. Faqet e tyre, zakonisht, mbyllen disa ditë përpara botimit. Në këto kushte nuk është e këshillueshme që të veni në redaksi një ditë para se të dalë gazeta. Më mirë do të ishte një ditë pasi ka dalë numri i fundit, kur situata në redaksi është krejtësisht e qetë.



Është e rëndësishme që të rinjtë të shikojnë dhe të vlerësojnë vetë interesin që paraqesin redaksitë për botimin e një artikulli që bëhet në kuadër të një projekti. Është e nevojshme që të pyesni në redaksi nëse ka nevojë për foto për të ilustruar njoftimin dhe nëse po, aktivizojini të rinjtë në përzgjedhjen e tyre. Gjithashtu, redaksia mund t'ju japë edhe disa këshilla specifike për gjatësinë e artikullit.

Njoftimi për shtyp, i përpunuar nga të gjithë të rinjtë, të jetë rreth 500 fjalë (nëse redaksia ju ka vendosur kërkesa të caktuara, mund të jetë edhe më shumë), si dhe të përmbajë çështjet më të mira të përpunuara nga njoftimi i nëngrupeve.

Ndodh që njoftimi i përpunuar në nivel nëngrupi është i tillë që e bën shumë të lehtë realizimin e ushtrimit. Në këtë rast, puna juaj është më e madhe, sepse ju duhet të nxirrni një material më të gjatë për t'u botuar në gazetë nga disa projekt materiale që janë krijuar. Që më parë ju keni dëgjuar se ç'kanë shkruar të rinjtë, madje keni marrë dhe shënime për krijimet më të mira. Kujtojuni të rinjve përparësitë e njoftimit për shtyp dhe mesazhet kryesore që do t'u përcjellin lexuesve. Duke marrë shkas nga këto gjëra, ju mund të bëni një formë kolazhi mbi bazën e të cilit të ndërtoni njoftimin përfundimtar për shtyp.

Njoftimi përfundimtar për shtyp



Pa dyshim që, para se të marrë formën e plotë, teksti duhet të shkurtrohet, të përshtatet në stil dhe të lidhet në tërësinë e tij. Mund të shkruani në dërrasën e zezë apo mund t'i kërkonti dikujt nga grupi ta shkruajë tekstin e plotë. Më e mira është të veproni në këmbë, në mënyrën e ngritjes së një kolazhi, dhe të qëndroni në pikat e dobta që kërkojnë ripunim. Përpunoni të përfshini të gjithë të rinjtë e grupit, duke i nxitur për të punuar me dëshirë.

Pasi të keni përpunuar variantin e përzgjedhur të njoftimit, jepini dorën e fundit për të patur një shkrim sa më të mirë. Bëni kujdes që grupi të shkruajë paragrafin e hyrjes duke iu përmbajtur teknikës së 5 pyetjeve.

Në përfundim, hidhini një sy përsëri titullit dhe gjithçkaje më të mirë që ka prodhuar grupi në lidhje me titullin. Në këtë fazë, lexojua njoftimin të gjithëve dhe merrni mendime dhe vlerësime përfundimtare. Më pas, teksti shkruhet nga një anëtar i grupit që ka shkrim të mirë ose mund të shkruhet në kompjuter duke e ruajtur në disketë.

Pasi të keni përgatitur variantin përfundimtar të njoftimit për shtyp, kërkojuni të rinjve të takojnë me personin përgjegjës në redaksi, si dhe të përcaktojnë nëse ka nevojë për foto ilustruese apo jo. Të gjitha njoftimet për shtyp, kur dorëzohen, duhet të ndiqen nga një telefonatë e bërë në redaksi, nga ana e grupit për t'u siguruar nëse ka mbërritur. Në redaksi mbërrijnë me qindra shkrime, prandaj ju duhet

Shënim për përdoruesin

Është mirë të respektohen të gjitha afatet për shkrimin e njoftimit të shtypit. Nëse në redaksi shkrimi duhet të mbrijë tri ditë para botimit, ju duhet të respektoni këtë gjë. Shkrimi duhet t'i dorëzohet personit përgjegjës që ka caktuar redaksia.

të siguroheni që njoftimi juaj ka mbërritur, si dhe të mësoni se kur do të botohet.

Në shtesën 2 jepet një njoftim i shkruar gjatë fazës së pilotimit të projekti në Republikën e Irlandës. Në të grupi juaj mund të gjej ndonjë çështje që paraqet interes.



Shënim për përdoruesin

Qëllimi është që njoftimi për shtyp i grupit tuaj të gjejë dritën e botimit në një prej organeve lokale në formën e një shkrimi. Nëse kjo realizohet, mënjëherë pas botimit së bashku me grupin shkruani një letër falenderimi për redaksinë. Më pas nxitini të rinjtë të telefonjnë në redaksi, pikërisht gazetarit me të cilin kanë punuar, për ta falenderuar dhe njëkohësisht t'i kërkojnë nëse është i interesuar të botojë shkrime të tjera me temën e punës së fëmijëve. Përsa i përket ndërgjegjësimit të komunitetit, shkrimi i një artikulli në gazetën lokale është një hap i rëndësishëm përpara. Ftojini grupin të ruajë gazetën ku është botuar artikulli. Nëse artikulli nuk botohet, mos e humbni shpresën, por lidhuni me redaksinë dhe gazetarin që është marrë, për të patur informacion rreth fatit të shkrimit. Ky është, gjithashtu, një ushtrim i dobishëm, pasi, ndonjëherë, shkak i mosbotimit është shumë i thjeshtë, nuk kanë patur vend dhe shkrimi mund të botohet në numrin e ardhshëm. Pasi të jeni njohur me motivin e mosbotimit, bëni të pamundurën që shkrimi të publikohet në numrin e ardhshëm.

Ç'duhet të mënjaroni

- Sigurohuni që të gjithë të japin ndihmesën e vet në të gjitha etapat e krijimit të njoftimit për shtyp.
- Sigurohuni që të gjitha grupet të shkruajnë një njoftim, pavarësisht gjatësisë dhe përpunimit të detajeve.
- Gjatë zhvillimit të sesionit bëni shaka me grupin. P.sh., humori mund të ketë shumë vlerë në përzgjedhjen e titullit.
- Mos e lejoni grupin të tallet me punët e kryera.
- Përgëzoheni grupin për punën që ka kryer, duke shtuar se do të përdoren pjesë të punës së të gjitha nëngrupeve në variantin përfundimtar të njoftimit për shtyp.
- Ruajini të gjitha punimet e bëra nga nëngrupet



Diskutimi përfundimtar

1 orë mësimi

Pasi të ketë përfunduar njoftimi për shtyp, vazhdoni me diskutimin përfundimtar. Për të rinjtë, puna me median është entuziasmuese. Edhe gjatë zhvillimit të modulit ata ndoshta kanë reaguar shumë mirë. Në përgjithësi, të rinjve u pëlqen të shfaqen nëpër gazeta, si dhe njerëzit që i rrethojnë, të lexojnë për nismat e tyre në kuadër të projektit. Ata natyrshëm do të jenë të kënaqur të shikojnë fotot e grupit të botuara në gazetë.

Mbajeni gjallë interesin dhe entuziazmin e grupit, duke bërë komentet tuaja në mënyrë të gjallë. Kërkojuni të gjithëve të kontrollojnë gazetën për të parë nëse shkrimi është botuar ose jo. Kjo krijon një atmosferë pritjeje të këndshme tek të rinjtë dhe një motivim për vazhdimësin e kësaj pune. P.sh., vetë redaksia mund të interesohet më shumë rreth zhvillimit të projektit të të rinjve. Gazeta mund të krijojë një hapësirë për botimin për disa numra me radhë të artikujve të ndryshëm. Mund t'i kërkonit gazetës të publikojë punime të tjera artistike të grupit (p.sh., tregime, vizatime etj.).



Vlerësimi dhe vazhdimi



Përsa u përket treguesve të suksesit të këtij moduli, duhet të kontrollohet nëse janë arritur disa synime thelbësore ose jo. Përfundimi i parë që duhet të verifikohet, është nëse nëngrupet e kanë shkruar njoftimin e tyre për shtyp. Duke u nisur nga vlerësimi i tyre, puna do të vazhdojë me vlerësimin e njoftimit përfundimtar të shkruar nga i gjithë grupi.

Gjithashtu, të mbahen parasysh edhe këto probleme:

- lidhjet e vendosura me shtypin lokal(ose kombëtar),
- dërgimin e njoftimit për botim,
- botimi i një artikulli mbi bazën e njoftimit për shtyp të shkruar nga grupi,
- zhvillimi i veprimtarive të tjera pas botimit.

Të gjitha veprimtarit e këtij moduli synojnë t'i përgatisin të rinjtë për fazën e veprimit konkret, e thënë ndryshe, të përfshirjes efektive të të rinjve në fushatën globale kundër punës së fëmijëve. Treguesit e mësipërm janë shumë të rëndësishëm për të treguar sa është përfshirë grupi në problematikën e punës së fëmijëve dhe sa janë të vendosur pjesëtarët e tij për të vepruar. Të tilla rezultate janë të rëndësishme për ju si edukator, që do të jepni një vlerësim për punën e grupit, në përgjithësi, dhe të individëve të veçantë. Në këtë shkallë ju tashmë i keni përzgjedhur anëtarët më të dalluar në punë.

Ky modul është veçanërisht i rëndësishëm për edukimin e të rinjve tuaj në grup. Veprimtaritë e modulit i mësojnë ata si duhet të veprojnë për të promovuar dhe për të ndërgjegjësuar opinionin në lidhje me punën e fëmijëve. Të rinjtë në këtë mënyrë i shprehin ndjenjat e tyre komunitetit. Nuk përjashtohet fakti që këto mesazhe të prodhojnë procese të reja. P.sh., të nxiti interesin e grupeve dhe të personave të tjerë, duke bërë të mundshme të lindnin nisma të reja, vetë shkollat mund të paraqesin interes për punën e nxënësve të tyre etj.

Botimi i këtij mesazhi mund të jetë çelësi që do të hapë

dyer të reja. Asnjëherë nuk i dihet se ç'të papritura të tjera mund të dalin(?!).

Veprimtaritë e modulit duhet t'i transmetojnë grupit mesazhin e shpresës. Vetë të rinjtë mund të kuptojnë se jo gjithçka është e kotë, pasi ka mënyra dhe mjete për të vepruar pozitivisht. Nëse moduli manaxhohet ashtu siç duhet, mund të jetë shumë efektiv. Nëse arrini të botoni njoftimin për shtyp, bëni të pamundurën që të gjithë të ndiehen krenarë. Kjo do t'u forcojë besimin në vetvete dhe do t'i motivojë për të vazhduar të punojnë më shumë e me më shumë vendosmëri për këtë çështje.

Pasi të keni mbaruar këtë modul, ju këshillojmë një modul tjetër që do ta përballë grupin me dukuri të tjera të fushatës mediatike (shiko modulën "Mjetet e komunikimit, radioja dhe televizioni"). Njoftimi për shtyp, i shkruar në kuadër të realizimit të këtij moduli, do të jetë një mjet i dobishme edhe për t'u përdorur në modulet e tjera.

Shtesa 1

Artikull i botuar në “Scariff News”, në Irlandë, mars 2001

Puna e fëmijëve

nga Antoinette Collins dhe Denis Bolton

(të dy nga 16 vjeç)

Ndoshta keni dëgjuar të flitet për projektin e mrekullueshëm për punën e fëmijëve, që po realizojmë ne studentët e vitit të ndërmjetëm¹ të kolegjit të komunitetit “Scariff”. Është një projekt që ka patur vlerë shumë të madhe informuese. Na ka bërë të zbulojmë një numër të madh mizorish që përfetojnë fëmijët, të cilët punojnë, si dhe motivet për të cilat ata janë të detyruar të punojnë.

Në fillim të punës, në kuadër të këtij projekti, kemi mbledhur copa të prera nga gazetatat dhe revistat e vjetra dhe kemi bërë dy kolazhe të ndryshme. I pari me temë të lirë dhe i dyti me temën e punës së fëmijëve. Ende i kemi të varura në muret e klasës. Çdo javë zhvillojmë dy ose tri sesione me temë për punën e fëmijëve, gjatë të cilave flasim për ngjarje që kanë të bëjnë me këtë problem. Jemi duke i regjistruar të gjitha sesionet që zhvillojmë në klasë, që t'i montojmë dhe të përgartim një video për projektin.

Një herë në javë, në orën e gjuhës angleze, kontrollojmë gazetatat për të parë nëse ka artikuj interesantë. Tashmë edhe mësues të tjerë po interesohen për projektin tonë. Gjatë mësimit diskutojmë për disa tematika që lidhen me punën e fëmijëve. P.sh., në orën e gjeografisë po studiojmë disa nga shkaqet e varfërisë.

Një veprimtari tjetër që zhvillojmë në kuadër të projektit, të cilën të gjithë e pëlqejmë shumë, është mësimi për teatrin, ndonëse janë të ndryshme nga njëri-tjetri. Aktualisht, po merremi me vënien në skenë të një pjesë, me të cilën do të përfaqësohemi në olimpiadën e teatrit që do të zhvillohet më 15 mars.

Më 14 shkurt kemi diskutuar në klasë rreth temës “Fëmijët duhet të

1. Viti i ndërmjetëm është një vit gjatë të cilit nxënësit që kanë mbaruar shkollën e mesme, krahas lëndeve shkollore, bëjnë shumë veprimtari, si: teatër, gazetari etj.

mësojnë në shkollë dhe jo të punojnë”. Ky debat na mësoi shumë gjëra. Një këshilltar i bashkisë së Clare, që ishte i pranishëm, u shpreh se ishte shumë i prekur nga mënyra si diskutonim për fëmijët. Mori pjesë edhe një parlamentar që, gjithashtu, mbeti shumë i befasuar nga projekti ynë. Disa nga nxënësit intervistuan të dy politikanët që morën pjesë.

Më 15 e16 shkurt morëm pjesë në një seminarë shumë interesant rreth shkrimit krijues me shkrimtarinë Larry O’Loughlin, autori i librit “A po na dëgjon ndonjë?”, që flet për punën e fëmijëve. Ishte një takim që na pëlqeu të gjithëve.

Projekti ynë u kushtohet të rinjve dhe asaj që ata mund të bëjnë për të mënjeluar plotësisht punën e fëmijëve në botë. Duke u njohur më mirë me problemin, duke njohur shkaqet që qëndrojnë në themel të kësaj dukurie, e ndiejmë se edhe ne mund të luajmë një rol aktiv. Pasi e njeh një problem, nuk është e mundshme të qëndrosh indiferent ndaj tij.

Duke përdorur njohuritë dhe teknikat që kemi mësuar, jemi të sigurtë që mund të japim ndihmesë për të ndryshuar gjërat. Pikërisht ky është objektivi i projektit tonë, pra të japim ndihmesë për të ndryshuar jetën e miliona fëmijëve që punojnë në të gjithë botën.

Shtesa 2

Njoftim për shtyp i grupit, Irlandë,
janar 2001

Një punë e bërë me dashuri nga nxënësit e Scariff-it

Një grup nxënësish të kolegjit të Scariff-it, po zhvillon një projekt të mrekullueshëm që mund të ndihmojë në çrrënjosjen e punës së fëmijëve në të gjithë botën. 24 nxënës të vitit të ndërmjetëm të shkollës së mesme në East Clear, po marrin pjesë në fazën eksperimentuese të një projekti-pilot që ka si qëllim të ndërgjegjësojë të rinjtë për problemet që lidhen me punën e fëmijëve.

Projekti mbikqyret nga ILO (Organizata Ndërkombëtare e Punës) në Gjenevë, Zvicër, dhe zhvillohet në kuadër të programit të IPEC-ut (Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve). Nick Grisewood, një këshilltar privat, specialist në shkencën e komunikimit që banon në Scariff, është angazhuar të studiojë një sërë modulesh edukativ që mund të përdoren në shkollat e gjithë botës. Nick është i mendimit se bashkëpunimi me shkollën është një ndër mënyrat më të mira për të trajtuar dhe për t'u ballafaquar me problemin e punës së fëmijëve. "Mënyra më e mirë për të ndryshuar një herë dhe përgjithmonë gjendjen e fëmijëve që punojnë, është edukimi dhe arsimimi, veçanërisht edukimi i të rinjve",- shprehet Nick.

Faza eksperimentale e projektit u zhvillua në bashkëpunim të ngushtë me mësuesit e kolegjit të Scariff-it. " Për nxënësit tanë ka qenë një përvojë e mrekullueshme pune në një kuptim më të gjerë, duke ndjerë se po marrin pjesë aktivisht në ndryshimin e gjërave. Është shumë e bukur që një shkollë e vogël si shkolla jonë në një zonë rurale të Irlandës, mund të japë ndihmesën e vet të rëndësishme në procesin e rëndësishëm të ndryshimit në botë",- pohon P. J. Mason, drejtori i kolegjit të komunës së Scariff-it.

Një veçanti e këtij projekti është se shtrihet në trajtimin e të gjitha lëndëve që bëjmë në shkollë, siç shpjegon Geraldin Condren, bashkërenduese e vitit të ndërmjetëm: "Nxënësit po e trajtojnë punën e fëmijëve nga shumë këndvështrime, duke realizuar postera në orët e edukimit artistik; duke studiuar temat e varfërsisë në orën e gjeografisë; duke studiuar poezi dhe prozë në orët e gjuhës irlandeze dhe angleze; po me këtë temë realizuan

një debat ku morën pjesë nxënësit e vitit të ndërmjetëm dhe të vitit të pestë”.

Projekti parashikon të përqendrohet në përdorimin e dramatizimit, të muzikës dhe të shkrimit krijues. Nxënësit po bashkëpunojnë me drejtorin e teatrit lokal për të vënë në skenë një pjesë teatrore, me të cilën do të përfaqsohen këtë vit në *festivalin e teatrove të East Clare*.

Komuniteti lokal po reagon shumë mirë ndaj projektit. Biblioteka lokale është përfshirë duke u afuar të rinjve, të përfshirë në projekt, kurse interneti dhe u ka vënë në dispozicion për punën e tyre kërkimore, të gjithë librat e saj.

Ndryshimet që synojnë të mënjanojnë plotësisht punën e fëmijëve, realizohen në nivel politik. Për këtë, nxënësit e vitit të ndërmjetëm ftuan edhe Tony Killeen T.D, dhe këshilltarin lokal të kontesë Paul Bulger të vizitonin kolegjin e Scariff-it dhe të shikonin me sytë e tyre punën që po bëjnë të rinjtë. Nga ana e tyre, ata morën zotim të bënin gjithçka në nivel lokal dhe kombëtar për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit ndaj këtij problemi. “Pjesëmarrja dhe entuziazmi i të rinjve janë nxitësi më i mirë për drejtuesit e IPEC në Gjenevë dhe në botë”, - pohoi Frans Roselaers, drejtori i programit IPEC në Gjenevë dhe vazhdoi: “Ne jemi të bindur se të rinjtë, duke i dhënë liri të plotë entuziazmit dhe imagjinatës së tyre, mund të fillojnë një lëvizje shoqërore pozitive. Duke vepruar kështu, edhe edukatorët duhet të pranojnë dhe të njohin aftësitë e të rinjve për të marrë përgjegjësi për të ndryshuar dhe, njëkohësisht, për të ndërtuar një kulturë të re të drejtave të njeriut”.

Në një vlerësim afatgjatë të projektit do të shikohet sa dhe si ka ndikuar fushata ndërgjegjësuere e nxënësve të kolegjit të Scariffit në përballje me problemet që ka Kontea e East Clare. Nënësi Nollaig Burk, që ndjek vitin e ndërmjetëm, shpjegon: “Mendohet që në të gjithë botën ka 245 milionë fëmijë që punojnë nën moshën 18 vjeç. Nga këta, 189 milionë punojnë në kushte të rrezikshme për jetën. Projekti ynë do të shtrihet në botë për të dhënë ndihmesë në rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të të rinjve në të gjitha vendet për tragjedinë e shfrytëzimit të punës së fëmijëve. Shpresa dhe dëshira ime është që ky ndërgjegjësim të na japë forcën dhe vullnetin që të ndihmojmë aktivisht në një ndryshim afatgjatë”.

Programi i IPEC-ut për të ndihmuar vendet e ndryshme në luftën kundër punës së fëmijëve ka filluar në vitin 1992, nëpërmjet programeve të kërkimit, veprimtarive të drejtpërdrejta, përpunimit të politikave ndërgjegjësuere. Aktualisht, programi i IPEC-ut është shtrirë në 74 vende, në të gjithë botën.

Shënime

A series of horizontal dotted lines for writing notes.